



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.622/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesat e Naim Çunakut, kandidat për kuvendin Komunal në Podujevë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si të pabazuara ankesat e datës 09.11.2017, parashtruara nga Naim Çunaku, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik LDK, me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, me shenjë ZL.Anr.622/2017 dhe ZL.Anr.624/2017 të datës 09.11.2017, të parashtruara kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare nga KQZ më datë 08.11.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar 2 ankesa me datë 09.11.2017 në ora 12:15 nga Naim Çunaku kandidat për kuvendin Komunal në Podujevë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, me të cilën kërkon që PZAP të urdhëroj KQZ-në që të bëjë rinumërimin e votave në fshatin Gllamnik dhe Peran, për vendvotimet nr. 1812E/01R, 1812E/02R, 1841E/1R, dhe 1841E/02D. Për më tepër ka theksuar se, në vendvotimin nr.1803E/2R, kemi deklarata indirekte se pjesëmarrësit në cilësi të vëzhguesit është bërë numërimi i votave të kandidatëve dhe po ashtu evidentimi në Formularët e Rezultateve të Kandidatëve FRK, duke shtuar se komisionarët i kanë ndarë fletvotimet në mes vete, secili nga radhët e subjektit të vet politik, duke manipuluar me vota të kandidatëve sipas dëshirës së tyre dhe favoreve individuale.

Paneli i PZAP -it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë, të cilat i evidenton me shenjë ZL.Anr.622/2017, për shkak të ekonomizimit të procedurës, dhe për shkak se të njëjtat kanë të bëjnë me çështje të njëjta.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesave në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesa nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet në ankesat e parashtruara, në kuptim të nenit 117 par 3 të LZP-së ku është përcaktuar: “*se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”. Paneli gjat vendosjes së ankesave i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në ankesa dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të provave, erdh në përfundm se pretendimet ankimore nuk janë të bazuara në prova të besueshme dhe si të tilla ankesat nuk i plotësojnë standartet ligjore për miratim si të bazuar.

Kjo për faktin se ankuesi në asnjë ankesë të tij nuk e ka specifikuar për asnjë vendvotim se sa vota i mungojnë, por vetëm ka kërkuar që te rinumërohen votat neper vendvotimet e cekura, prandaj nuk e ka dëshmuar në asnjë ankesë me prova se sa vota i mungojnë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr. 622/2017 me datën 10.11.2017



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.